

Eppc kërkon një **Shef/e Finance** për klientin e saj, një ndër kompanitë më të mëdha që operon në sektorin e shitjeve me shumicë dhe pakicë.

## Përgjegjësitë Kryesore:

- Zotëron dhe menaxhon proceset e kontrollit të brendshëm për të mbrojtur asetet e kompanisë dhe raportimit financiar;
- Menaxhon Kontabilitetin dhe Financat e kompanisë, duke siguruar performancë të mirë të funksionit të përgjithshëm të kontabilitetit dhe të dhënave të besueshme të kontabilitetit;
- Përgatit pasqyrat financiare, raportet financiare, analiza speciale, dhe raportet informative;
- Mbikqyr, miraton dhe përpunon raportin e të ardhurave, shpenzimeve dhe dokumentet e kontrollit, buxhetet e departamenteve, librin dhe mirëmbajtjen e llogarive dhe hedhjen e të dhënave;
- Koordinon programet financiare, duke përfshirë buxhetimin aktiv, etj;
- Analizon pasqyrat financiare për të identifikuar fushat e mundshme të dobëta;
- Kryen rakordime periodike me klientët dhe furnitorët e ndryshëm të kompanisë.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë universitare - në financë / kontabilitet , diplomë Master përbën avantazh;
- Aftësi teknike në kontrollin financiar, kontabilitetit , raportimit të menaxhimit , menaxhimit të performancës ;
- Minimumi 3 vjet eksperiencë pune në kontabilitet;;
- Aftësi dhe njohuri të programit Navision;
- Aftësi të mira analitike dhe vendimmarrëse.

## Të dhënat:

**Pozicioni:** Shef/e finance;  
**Vendndodhja:** Durrës / Tiranë;  
**Pagesa:** Shumë e mirë ;  
**Kontrata:** Sipas Kodit të Punës;  
**Aplikimet mbyllën:** 6.11.2017

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail<sup>it</sup>:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.  
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.